



Pranimi / Proclamation / Declaration / Proclamation	29.12.2020	0	viti / god / year
Organizimi / Organization / Structure / Organization	SKIMSHCK	3327/2020	113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.345/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kane shqyrtuar ankesën me numër A.nr.345/2020 të datës 05.11.2020 e parashtruar nga ankuesja [REDACTED] me adresë rruga "Gursel Bajram-Sylejmani", Komuna e Ferizajt, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.345/2020 e datës 05.11.2020 e parashtruar nga ankuesja [REDACTED].

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, në bazë të autorizimit të datës 10.09.2019 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, me datën 14.09.2019, ka shpallur konkurs për rekrutimin e pozitës "Asistent administrativ", në Qendrën për Regjistrimin e Automjeteve në Fushe Kosovë, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe kandidatja [REDACTED].

Me datën 11.09.2019, ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria e Administratës Publike me datën 07.10.2019, ka njoftuar të gjitha institucionet publike për hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarë Publik dhe ka udhëzuar që të gjitha procedurat e konkurseve të cilat janë shpallur sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të pezullohen përkohësisht.

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me datë 25.11.2019 është pezulluar me vendimin Nr. ref.:VVMP 1525/20 për Masë të Përkohshme nga Gjykata Kushtetuese. Pas vendosjes së masës së përkohshme të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ministria e Administratës Publike me datë 10.01.2020 ka lëshuar njoftim me shkrim dhe ka udhëzuar të gjitha



institucionet publike që ti aplikojnë dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil. Bazuar në këtë njoftim, Ministria e Punëve të Brendshme ka vazhduar procedurën e pezulluar për rekrutimin e pozitës "Asistent administrativ" në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Fushe Kosovë, ku ka themeluar Komisionin Përzgjedhës, ka organizuar testin me shkrim, intervistën me gojë dhe në tërësi ka përfunduar procedurën e rekrutimit me datën 30.01.2020 përmes publikimit të njoftimit për kandidatin e suksesshëm [REDAKTUAR].

Me datën 17.06.2020, U.d. e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme ka nxjerr Vendimin Nr.466, me të cilin ka anuluar konkursin e datës 14.09.2019, me arsyetimin se Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administratës Publike preken nga procesi i fuzionimit apo bashkimit sipas Vendimit nr. 07-v-005 të datës 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe procedura e listës se ngushte është bërë jashtë afatit prej 5 dite të përcaktuar sipas Rregullores për Procedurat e Rekrutimit.

Ankuesja, kundër njoftimit për anulimin e konkursit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datën 05.11.2020, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2452/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 09.11.2020, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. Ministria e Punëve të Brendshme me datën 25.11.2020, ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Me datën 16.12.2020 nëpërmjet e-mailit zyrtar kemi kërkuar nga znj. [REDAKTUAR] - Udhëheqëse e Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, nëse ankuesja [REDAKTUAR] ka parashtruar ankesë në KZKA apo në Ministri, dhe përgjigja me datë 16.12.2020 nga [REDAKTUAR]-Zyrtare e lartë e burimeve njerëzore, ka qenë që "kandidatja Albina Ibrahimini nuk ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe as në Ministrinë e Punëve të Brendshme".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2452/2020 të datës 05.11.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim i datës 30.01.2020 për kandidatin e suksesshëm; Kopja e letërnjoftimit të ankueses; Përgjigja në ankesë e datës 25.11.2020 nga MPB; Autorizim nga MAP i datës 10.09.2019; Raporti përmbledhës i Komisionit rekrutues i datës 29.01.2020; Vendim i datës 17.06.2020 për anulim të konkursit; Njoftim i datës 18.06.2020 për anulim të konkursit nga MPB; Form.MAP-SHCK-08 formulari për vlerësimin individual të kandidateve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për ankuesen [REDAKTUAR]; Intervista me gojë e datës 27.01.2020; Lista e aplikantëve për intervistën me gojë e datës 27.01.2020; Lista e aplikantëve sipas pikëve të fituara nga testi me shkrim i datës 23.01.2020; Form.MAP-SHCK-05 i formularit për përcaktimin e kritereve për përfshirjen në listën e ngushte i datës 20.01.2020; Form.MAP-SHCK-07 a formulari për përcaktimin e kritereve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Lista e ngushte e aplikantëve për testin me shkrim e datës 22.01.2020; Lista e ngushte e datës 20.01.2020; Vendim i datës 03.10.2019 për themelimin e komisionit përzgjedhës të shërbimit civil; Regjistri i aplikacioneve të listës së gjere i datës 04.10.2019; Test me shkrim i datës 22.01.2020; Kërkesa për punësim të ankueses e datës 20.09.2019 me shkresat e bashkangjitura; Konkurs i

datës 14.09.2019; Vendimi me numër 24/2020 i datës 21.12.2020 i KPMSHCK-së për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës me numër A. Nr. 345/2020 të datës 05.11.2020, të parashtruar nga ankuesja [REDAKTUAR].


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses [REDAKTUAR], është bërë i pamundur, sepse:


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja me datën 05.11.2020, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa me datën 28.12.2020, ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 3309/2020 me të cilën ka deklaruar se e tërheq ankesën e datës 05.11.2020, me arsyetimin që KPMSHCK ka anuluar vendimin me numër Nr. 466 të datës 17.06.2020 të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të kësaj rrethane, konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e palës e përcaktuar me dispozitat nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.345/2020

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses [REDAKTUAR];
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

